



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A

Nr. 514/2 prot.

Tiranë, më 18.3.2024

Lënda: Njoftim për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive të punës.

ORGANIZATAVE PËRFAQËSUESE SINDIKALE

Baza ligjore: Neni 50 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 159 e vijues i Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë” (i ndryshuar), si dhe kërkesa me nr.702 prot, datë 08.02.2024 e Konfederatës së Sindikatës së Shqipërisë (KSSH), Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë (FSPTTSH),

Me qëllim mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave, interesave ekonomike, profesionale dhe sociale të punonjësve, lidhur me rregullimin e marrëdhënies së punës dhe ushtrimin e veprimtarisë sindikaliste si dhe duke marrë shkas nga kërkesa për lidhjen e kontratës kolektive pranë Posta Shqiptare sh.a., nga ku synojmë ndalimin e diskriminimit padrejtësisht, sigurimin e besimit dhe transparencës për këtë procedurë, si dhe trajtimin e barabartë të organizatave sindikale që mund të shprehin interes për lidhjen e marrëveshjes kolektive të punës, Shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a.,:

Fton të gjithë Organizatat Përfaqësuese Sindikale të interesuara të paraqesin pranë Drejtorisë së Përgjithshme në adresën: **Rruga “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë (Zyra e Protokollit)**, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi:

1. Kërkesën me shkrim për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive;
2. Statutin e Sindikatës;
3. Treguesit mbi përfaqësueshmërinë.

Kjo bazuar në nenin 163, pika 3 e K.P.R.SH “Kërkesa për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive bëhet me shkrim. Ajo shoqërohet me kopjen e statutit të organizatës ose organizatave kërkuese sindikale, si dhe me treguesit e nevojshëm mbi përfaqësueshmërinë e këtyre të fundit në ndërmarrje, ndërmarrjet ose degën e caktuar”

Në përfundim të afatit 14 (katërbëdhjetë), Grupi i Punës do të mbyll fazën e pranimit të kërkesave dhe dokumentacionit shoqërues. Çdo kërkesë e ardhur pas përfundimit të afatit më sipër nuk do të merret parasysh.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti konsiderohet si kusht për skualifikim.

Më tej, do të procedohet, me publikimin e kërkesave duke i afishuar në vende të dukshme, në ambientet e Drejtorisë së Filialeve/Degëve dhe Zyrave Postare.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

